

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Hasan Shala dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Qendra për Ndihmë Juridike “Clard” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.867/2013, të datës 08.09.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses Qendra për Ndihmë Juridike “Clard” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.867/2013, i datës 08.09.2016, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.867/2013, të datës 08.09.2016, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Qendra për Ndihmë Juridike “Clard” me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar të anulohet vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë, me nr.39/2013 të datës 27.05.2013.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësja Qendra për Ndihmë Juridike “Clard” me seli në Prishtinë, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit jo të drejtë të së drejtës materiale. Duke pohuar se provat dhe faktet e argumentet të cilat i ka prezantuar nuk janë vlerësuar ashtu si që duhet dhe një vendim i tillë e ka dëmtuar rëndë paditësen e cila ka qenë dhe është e përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenuara dhe të marginalizuara duke iu ofruar shërbime ligjore falas. Me propozim që të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda të kthehet në rishqyrtim për të vlerësuar drejtë gjendjen faktike dhe mbi bazën e provave të merret një vendim merititor.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 par.1 të LKA-së, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi për konflikt administrativ kundër vendimit të së paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektorati të Punës, me nr.39/2013 të datës 27.05.2013, sepse konsideron se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa bazë dhe jo i ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike, nga ana e organeve administrative kur i është shqiptuar masa ndëshkuese vërejtje me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, duke u bazuar në provat siç janë: marrëveshja me nr. 9- 22-11 e datës 28.09.2011, vendimi me nr.39/2013 i datës 27.05.2013, raporti zyrtar i datës 22.02.2013 me numër të regjistrit 5111644-5, raporti zyrtar me numër 013442, vendimi me nr.01nr.56-21/2013, ankesa e datës 13.05.2013 me numër 182/2013, shkresa e datës 12.11.2012 , e-maili i datës 21.11.2012, fletë-lëshimi dhe ekspertiza e datës 09.11.2012, ankesa e datës 04.02.2013 dhe kontrata e datës 15.08.2011, si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Andaj duke u bazuar në provat e cekura më lartë gjykata e shkallës së parë, vendosi që ta refuzoj padinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancën gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës ka konstatuar se padia e paditëses është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Ndërsa sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses në padi janë të pabazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ është në pajtim me dispozitatat ligjore në fuqi.

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar e ka dëmtuar rëndë paditësen e cila ka qenë dhe është e përkushtuar për mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenuara dhe të

margjinalizuara duke iu ofruar shërbime ligjore falas, kjo për faktin se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me këto shkelje. Ngase dispozitivi i aktgjykimit të atakuar nuk është i pakuptueshëm, në kundërtënie me vet veten ose me arsyet e aktgjykimit, por aktgjykimi ka arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Ngase inspektorët e punës me raport zyrtarë 01 nr.56-21/2013, kanë konstatuar gjendjen faktike se ka pas parregullsi nga marrëdhënia e punës, dhe kanë konstatuar së subjekti në procedurë nuk ka respektuar nenin 49 par.1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës të Kosovës. Ndërsa me raport zyrtar urdhëron punëdhënësin që në afat prej 3 ditësh të lëshoj vendim për pushimin e lehonisë për punëtoren Merita Musa, me pretekst të paguaj edhe tre muaj e gjysmë me kompensim 70% të pagës bazë si e drejtë e fituar. Ndërsa me vendimin 01nr.56-21/2013 ka obliguar punëdhënësin ti eliminoj parregullsitë e konstatuara, dhe i ka shqiptuar masën ndëshkuese vërejtje me shkrim. Prandaj këto arsye nuk janë të paqarta apo në kundërtënie si dhe mbi faktet relevante nuk ekzistojnë kundërtënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit theksohet rreth përmbajtjes së dokumenteve apo të vendimeve dhe se me këtë drejtim janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses. Ndërsa, pretendimet tjera ankimore të paditëses ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa ne arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet e nevojshme mbi faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditëses dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.370/2016, me datë 05.01.2017

Kryetari i kolegjit
Ramiz Kuqi